



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:081778

Datë: 04.01.2023

Numri i dokumentit: 03824805

P.nr.101/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit Z.V nga fsh....- Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/IL.nr.566/22 të datës 19.04.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 15.12.2022, në prezencë të: Prokurorit të Shtetit Albert Zejnullahu, përfaqësueses së të dëmtuarës, D.L dhe të pandehurit, më datë 20.12.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 04.01.2023 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Z.V nga Ferizaj, rr.”...” ndërtesa “...”kati ... nr., i lindur më dt. ..., nga i ati B... dhe e ëma M..., e gjinisë U..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar prind i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në kompaninë “...”në Kaçanik, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 01.06.2021 në fsh. ... Komuna Kacanik, saktësisht në shtëpinë e tij me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme e që vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohen vetëm me shkëmbim të kompensimit , në atë mënyrë që pas një kontrolli të njehsorit elektrik me numër .. nga zyrtarët e ...-it, është konstatuar se njehsori ka qenë i shkyqur nga distanca , nga rrjeti elektrik dhe është hasur në lidhje direkte , duke u kyqur përmes një kabulli 3x2,5 cm, pa autorizimin e furnizuesit, ashtu që energjia elektrike e shfrytëzuar nuk është regjistruar, dhe me këtë veprim sipas të dëmtuarës-...-Distrikti në Ferizaj, është shkaktuar dëm në shumë prej 242,22 €.

Me këto veprime, i pandehuri Z.V, ka kryer veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,3,38,43,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 te KPRK-së, dhe nenit 359,360,361 dhe 365 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 250.00 €(dyqind e pesëdhjetë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në dy këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€, ne emër të paushallit gjyqesor, derisa per Fondin per kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30.00€, në afat te njëjtë me gjoben, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara, ...- Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në contest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën, PP/II.nr.566/22 të datës 19.04.2022, të pandehurin Z.V, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne shqyrtimin fillestar të dt. 07 shtator 2022 palët janë pajtuar që lënda të referohet ne procedurë të ndërmjetësimit, mirepo meqë palët nuk kanë arritur marreveshje në procedurë të ndërmjetësimit, gjykata ka vazhduar me shqyrtimin e rregullt të lëndës.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 15 dhjetor 2022, prokurori I shtetit Albert Zejnullahu deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës së parashtruar pranë kësaj gjykate.

Perfaqesuesja e të dëmtuarës me autorizim D.L, ne fjalën e saj deklaroi se I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesën pasurore juridike.

I pandehuri, pas administrimit të provave të propozuara me aktakuzë, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza.

Prokurori I shtetit ne fjalën e tij eshte dakorduar me pranimin e fajesisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 326 të KPK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbeshtetet ne faktet e çeshtjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor por edhe nga vetë mbrojtja e te pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike

si ne dispozitiv, andaj edhe i propozon gjykatës qe te pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'i shqiptoje sanksion penal sipas ligjit.

I pandehuri ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se , arsyeja e vendosjes së kabllos në fjalë, ka qenë se për shkak të kushteve jo të mira ekonomike, nuk ka mundur që t'i paguajë faturat me rregull, prandaj edhe si pasojë e borgjit rrjedhimisht është shkyqur nga rrjeti elektrik, por ka shtuar se i vjen keq për veprimin e tij, dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk d të përsërisë në të ardhmen, njeherit ka kërkuar që me rastin e marrjes së vendimit i njëjti të lirohet nga akuza dhe dëmi të vlerësohet me pak meqë nuk jeton vazhdimisht në atë shtëpi.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen te gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 te KPRK-se.

Me rastin e caktimit te dënimit gjykata pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese konform nenit 70 te KPRK-se, kështu qe si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësine për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, ka premtuar para gjykates se veprime te tilla nuk do te përsërisë në të ardhmen, bazuar ne evidencen penale nuk ka raste tjera me aktgjykim dënues te formës së prerë, ndërsa si rrethanë te posaçme renduese gjykata nuk gjeti përpos veprimeve të pandehurit te cilat paraqesin tiparet e veprës penale për te cilën eshte shpallur fajtor.

Andaj gjykata, për arsyet e cekura si më lartë, të pandehurin Z.V, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 te KPRK-se, e gjykoi me dënim si në dispozitiv të ketij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e te pandehurit, dhe se se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe te mos kryejnë vepra te tilla penale dhe se me ketë do te arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i parapare ne nenin 38 te KPRK-se.

Vendimi për shpenzimet e procedures është i bazuar në dispozitën e nenit 450 par 2 të KPPK-se.

Vendimi per kerkesen pasurore juridike u mor konfor nenit 463 te KPP-se .

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
P.nr.101/22 datë 04.01.2023

Sekretarja Juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.